
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: GJEO-PROJEKT SH.P.K. me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	11.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **10.06.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **10.06.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

PRETENDIMI 1

Në dosjen e tenderit është specifikuar se Operatori Ekonomik duhet të posedojë një dorn për spërkatje me kapacitet minimum 20L. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është e qartë nëse

2/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

nënkupton detyrimisht pronësinë e pajisjes apo nëse lejohet që e njëjta të sigurohet edhe përmes shfrytëzimit (qira apo marrëveshje bashkëpunimi). Duke pasur parasysh praktikën e prokurimit publik, kërkojmë sqarim nga Autoriteti Kontraktues nëse kjo pajisje duhet të jetë në pronësi të OE apo mund të dëshmohet edhe përmes një marrëveshjeje për përdorim gjatë realizimit të kontratës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Ne baze të Konsultimeve, nga **Njësia Kërkuese** kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me pronësinë, shfrytëzimin dhe dokumentimin e pajisjeve UAS

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesa për pajisje UAS/dron për spërkatje bujqësore nuk duhet të interpretohet vetëm si kërkesë për pronësi direkte të pajisjes nga Operatori Ekonomik, por si kërkesë për disponueshmëri ligjore, teknike dhe operative të pajisjes për realizimin e kontratës.

Në praktikë, dronët për spërkatje bujqësore, në momentin e regjistrimit pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, regjistrohen dhe lidhen me operatorin/pilotin përkatës, i cili mund të jetë person fizik i certifikuar dhe i autorizuar për operim. Për këtë arsye, edhe në rastet kur Operatori Ekonomik posedon dronët si asete të kompanisë, operimi i tyre duhet të kryhet nga personi fizik/operatori i autorizuar, sipas kërkesave të aplikueshme të AAC-së.

Rrjedhimisht, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka marrëdhënie të vlefshme juridike me personin fizik/operatorin e autorizuar që do të kryejë shërbimin. Kjo mund të bëhet përmes kontratës së punës, kontratës për shërbim, marrëveshjes së bashkëpunimit apo një dokumenti tjetër të vlefshëm që dëshmon se personi fizik/operatori i autorizuar është i angazhuar nga Operatori Ekonomik për realizimin e shërbimit të kërkuar.

Pra, Operatori Ekonomik mund të ketë në pronësi dronët si asete, mund t'i ketë në shfrytëzim përmes marrëveshjes apo kontratës, por në çdo rast duhet të dëshmojë se pajisja UAS dhe personi fizik/operatori që e operon atë janë të autorizuar dhe të disponueshëm për realizimin e kontratës.

Prandaj, ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse Operatori Ekonomik dëshmon:

- disponueshmërinë e pajisjes UAS për realizimin e kontratës
- dokumentacionin përkatës të regjistrimit/autorizimit të pajisjes dhe operatorit sipas kërkesave të AAC-së
- kontratë valide ose marrëveshje të vlefshme me personin fizik/operatorin e autorizuar që do të kryejë shërbimin

Prandaj, ky pretendim sqarohet në këtë mënyrë: nuk kërkohet vetëm pronësi direkte, por kërkohet dëshmi e qartë për disponueshmërinë dhe përdorimin e ligjshëm të pajisjes gjatë realizimit të kontratës.

Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Pretendimi 2:

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që piloti i dronit të jetë i certifikuar me certifikatë A4. Megjithatë, ju njoftojmë se në rastet kur pajisja (droni) merret në shfrytëzim dhe angazhohet një pilot nga shtetet fqinje ose nga vendet e BE-së, në legjislacionet përkatëse nuk ekziston certifikimi A4, pasi sipas rregullores së BE-së aplikohen kategoritë A1, A2 dhe A3. Duke qenë se rregullorja e Kosovës nr. 01/2026 nuk është plotësisht e harmonizuar me Rregulloren e BE-së 2019/947, kërkojmë sqarim nga Autoriteti Kontraktues nëse ky kriter konsiderohet i përmbushur edhe nga pilotët e certifikuar sipas standardeve të BE-së. Në të kundërtën, kërkojmë rishikimin dhe harmonizimin e këtij kriteri për të mundësuar konkurrencë të drejtë dhe trajtim të barabartë të Operatorëve Ekonomikë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me certifikatën A4 të pilotit

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesa për certifikatë A4 është vendosur duke u bazuar në kërkesat dhe klasifikimet e aplikueshme për operate me UAS në Republikën e Kosovës.

Meqenëse shërbimi do të realizohet në territorin e Republikës së Kosovës, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që piloti/operatori i angazhuar të jetë i pajisur me certifikim, njohje, autorizim apo dokumentacion të pranueshëm sipas kërkesave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Në rast se piloti është i certifikuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian, si A1/A2/A3 apo certifikime tjera relevante, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që këto certifikime pranohen ose mund të njihen për operim në Kosovë nga autoriteti kompetent.

Autoriteti Kontraktues nuk ka për qëllim kufizimin e konkurrencës, por nuk mund të heqë dorë nga kërkesa që operimi të jetë i ligjshëm dhe i pranueshëm për autoritetet kompetente të aviacionit civil në Kosovë.

Prandaj, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse Operatori Ekonomik dëshmon njërin nga këto:

- certifikatë A4 sipas kërkesave vendore
- ose certifikatë ekuivalente të pranueshme nga AAC e Kosovës
- ose dokument/autorizim nga AAC që lejon operatorin/pilotin të kryejë operate përkatëse në territorin e Kosovës.

Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

PRETENDIMI 3

Lidhur me Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, pika 1, ku kërkohet që operatori ekonomik të posedojë:

- Certifikatë valide të regjistrimit të operatorit UAS nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC);
 - Dëshmi për regjistrimin e pajisjes UAS në AAC;
 - Numër valid operatori UAS;
1. Prona apo shfrytëzimi i pajisjes (UAS/drone):
Në kërkesat e lartcekura nuk është specifikuar nëse pajisjet UAS duhet të jenë pronë e operatorit ekonomik që aplikon, apo lejohet edhe marrja në shfrytëzim (p.sh. përmes kontratës së qirasë apo bashkëpunimit) për realizimin e projektit.
 2. Regjistrimi i dronëve në AAC dhe operatorët e huaj:

Kërkesa që pajisja UAS të jetë e regjistruar në AAC nënkupton që pranohen vetëm pajisjet e regjistruara në Kosovë, duke kufizuar kështu pjesëmarrjen e operatorëve që mund të përdorin pajisje të regjistruara jashtë vendit.

Ndërkohë, sipas Rregullores (AAC) Nr. 01/2026 për operimin e sistemeve të mjeteve

ajrore pa pilot, konkretisht neni 7, pika 7.8, përcaktohet se:

7.8 SAP që janë të regjistruara në një shtet të huaj nuk kanë nevojë të regjistrohen në AAC. Megjithatë, pronari/operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm që do të kërkohet nga AAC

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me regjistrimin e dronit në Aviacionin Civil

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesa për regjistrim në Aviacionin Civil ka për qëllim garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe gjurmueshmërisë së pajisjes UAS që do të përdoret për realizimin e shërbimit.

Nëse pajisja UAS është e regjistruar në Republikën e Kosovës, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi përkatëse të regjistrimit.

Nëse pajisja UAS është e regjistruar jashtë Kosovës ose angazhohet nga një operator i jashtëm, atëherë Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se përdorimi i saj në territorin e Kosovës është i lejuar dhe në përputhje me rregullat e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, qoftë përmes:

- lejes/autorizimit për operim
- njohjes së dokumentacionit të huaj
- ose ndonjë dokumenti tjetër zyrtar të pranueshëm nga AAC.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të pranojë operim të pajisjeve UAS pa bazë ligjore dhe pa dëshmi se operimi është i lejuar në territorin e Kosovës. Prandaj, kërkesa nuk përbën kufizim të konkurrencës, por është kërkesë minimale për siguri dhe ligjshmëri.

Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

PRETENDIMI 4

Në Dosjen e Tenderit, konkretisht në paramasë, janë evidentuar disa paqartësi lidhur me sipërfaqen për realizimin e shërbimeve. Në një pjesë të dokumentacionit është specifikuar sipërfaqe për spërkatje prej 1500 ha, ndërsa në Dosjen e Tenderit përmendet sipërfaqe prej 1000 ha. Gjithashtu, në disa pozicione të paramasës janë paraparë aktivitete si krijimi i raporteve dhe identifikimi për sipërfaqe prej 700-750 ha. Kjo mospërputhje krijon paqartësi në interpretimin e kërkesave dhe në përllogaritjen e ofertës. Në këtë kontekst, kërkojmë sqarim nëse për çdo sipërfaqe që spërkatet kërkohet edhe hartimi i raporteve përkatëse, si dhe kërkojmë korrigjimin e gabimeve teknike në Dosjen e Tenderit për të siguruar qartësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë Operatorët Ekonomikë

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me sipërfaqet 1500 ha, 1000 ha dhe pozicionet 700–750 ha

Autoriteti Kontraktues sqaron se, për qëllime të këtij aktiviteti të prokurimit, sipërfaqja e kontraktuar për realizimin e shërbimit është 750 ha. Shërbimet përcjellëse si identifikimi i parcelave, regjistrimi i koordinatave, monitorimi dhe raportimi teknik janë të lidhura me sipërfaqet që trajtohen dhe shërbejnë për dokumentimin, verifikimin dhe pranimin e shërbimit.

Njësia matëse për realizimin dhe përllogaritjen e shërbimit është ha, ndërsa oferta duhet të përgatitet duke marrë për bazë sipërfaqen kontraktuale prej 750 ha. Çdo referencë tjetër në dokumentacion që mund të krijojë paqartësi duhet të interpretohet në përputhje me këtë sqarim dhe me objektin kryesor të kontratës: spërkatjen e kulturave bujqësore me dron.

Ky sqarim nuk ndryshon objektin e kontratës, por qartëson fushëveprimin dhe mënyrën e përllogaritjes së ofertës për të gjithë Operatorët Ekonomikë.

Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

PRETENDIMI 5

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik të prezantojë kapacitete me minimum 2 njësi rezervë UAS ose alternativisht një plan zëvendësimi brenda 24 orëve në rast defekti. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është e qartë nëse nënkupton që OE duhet të posedojë gjithsej 3 dronë (një operativ dhe dy rezervë), apo nëse lejohet sigurimi i këtyre kapaciteteve përmes marrëveshjeve me Operatorë të tjerë Ekonomikë. Gjithashtu, nuk është e specifikuar qartë se me çfarë dokumentacioni duhet të dëshmohet ky kapacitet (p.sh. dëshmi pronësie, kontratë qiraje, marrëveshje bashkëpunimi apo plan operacional). Në këtë kontekst, kërkojmë sqarim nga Autoriteti Kontraktues si dhe, nëse është e nevojshme, plotësimin dhe qartësimin e kësaj kërkesë për të shmangur paqartësitë dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë Operatorët Ekonomikë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5 Ankimor:

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me kapacitetin rezervë UAS dhe planin e zëvendësimit

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesa për kapacitet rezervë UAS ka për qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe shmangien e ndërprerjes së punës në rast të ndonjë defekti teknik, jo krijimin e një kërkesë të panevojshme për posedimin e tre apo më shumë dronëve.

Për këtë aktivitet, kërkesa duhet të kuptohet se Operatori Ekonomik duhet të ketë në dispozicion minimum dy pajisje UAS për spërkatje bujqësore, ku njëra pajisje përdoret për realizimin e operimeve, ndërsa pajisja tjetër duhet të jetë në gjendje gatishmërie për zëvendësim, në rast se pajisja kryesore pëson defekt apo bëhet përkohësisht e papërdorshme.

Pra, nuk kërkohet që Operatori Ekonomik të posedojë gjithsej tre dronë, përkatësisht një dron operativ dhe dy dronë rezervë. Një interpretim i tillë nuk është qëllimi i Autoritetit Kontraktues dhe do të ishte joproporcional me objektin e kontratës.

Qëllimi i kërkesës është që Operatori Ekonomik të dëshmojë se ka kapacitet të vazhdojë realizimin e shërbimit pa ndërprerje të panevojshme, duke pasur së paku një pajisje UAS funksionale në operim dhe një pajisje tjetër në dispozicion për zëvendësim brenda afatit të kërkuar.

Ky kapacitet mund të dëshmohet përmes:

- dëshmisë së pronësisë së pajisjeve
- kontratës së qirasë
- marrëveshjes së bashkëpunimit
- kontratës për shfrytëzim
- listës së asetëve në dispozicion
- ose planit operacional për zëvendësim brenda 24 orëve.

Autoriteti Kontraktues sqaron se pajisja rezervë mund të jetë në pronësi të Operatorit Ekonomik, në shfrytëzim, me qira ose e siguruar përmes marrëveshjes së vlefshme bashkëpunimi, për aq kohë sa Operatori Ekonomik dëshmon se ajo është realisht e disponueshme për realizimin e kontratës në rast nevoje.

Pretendimi Nr. 6 Ankimor:

PRETENDIMI 6

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit, konstatojmë mungesë të harmonizimit ndërmjet kërkesave teknike dhe kushteve kontraktuale.

Bazuar në praktikat agronomike, periudha optimale për trajtimin e cikadisë është nga **15 maji deri më 30 qershor**, ndërsa jashtë kësaj periudhe efekti i trajtimit është minimal. Megjithatë, dokumentacioni nuk përcakton afat të saktë për realizimin e trajtimit, ndërkohë që kontrata është paraparë për 12 muaj.

Njëkohësisht, kërkesa për **kapacitet operativ prej 90 ha/ditë** është e arsyeshme vetëm nëse trajtimi realizohet brenda kësaj periudhe të kufizuar, çka aktualisht nuk reflektohet në dokumentacion.

Kjo mospërputhje krijon paqartësi dhe huti për operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Prandaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

- Të përcaktojë qartë periudhën e detyrueshme të trajtimit
- Të harmonizojë kohëzgjatjen 12-mujore të kontratës me natyrën sezonale të shërbimit;
- Të rishikojë kërkesën për kapacitetin prej 90 ha/ditë në përputhje me periudhën reale të realizimit;
- Të përpilojë Dosjen e Tenderit në përputhje me planin e kontratës, për të shmangur paqartësitë.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 6 Ankimor:

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Lidhur me pretendimin për kërkesa diskriminuese dhe kufizim të konkurrencës

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin se kriteret teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë diskriminuese ose të hartuara për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë.

Kriteret si kapaciteti operativ ditor, sistemi radarik për shmangie të pengesave, bateritë rezervë, sistemi i karikimit në terren, reagimi brenda afatit të caktuar dhe plani i zëvendësimit në rast defekti janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i cili është realizimi i shërbimit të spërkatjes së kulturave bujqësore me dronë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Ky aktivitet nuk është shërbim i thjeshtë administrativ, por shërbim sezonal dhe operativ në terren, ku vonesat, defektet teknike, mungesa e pajisjeve rezervë ose pamundësia për reagim në kohë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e trajtimit, mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe interesin publik të fermerëve përfitues.

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesat teknike nuk janë vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar që operatori ekonomik fitues të ketë kapacitet real teknik dhe operativ për realizimin e kontratës. Në Aneksin 1 kërkohet, ndër të tjera, kapacitet minimal prej 90 ha/ditë në kushte standarde, sistem radarik për shmangie të pengesave, raportim digjital, bateri rezervë, karikim në terren, reagim brenda 24–48 orëve dhe raportim për çdo operim.

Në veçanti, sistemi radarik për shmangie të pengesave është kërkesë e arsyeshme për operime në zona rurale ku mund të ketë pemë, shtylla, rrjete elektrike, objekte, terren të pabarabartë dhe pengesa të tjera. Kjo kërkesë lidhet me sigurinë e operimit, mbrojtjen e pajisjes, mbrojtjen e pronës dhe shmangien e dëmeve në terren.

Sa i përket kapacitetit rezervë UAS, Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi nuk është që të kërkohen pajisje të tepërta, por të sigurohet vazhdimësia e punës. Kërkesa duhet të kuptohet si nevojë për minimum dy pajisje UAS në dispozicion: një pajisje për operim dhe një pajisje në gjendje gatishmërie për zëvendësim në rast defekti, në mënyrë që shërbimi të mos ndërpritet.

Në rastin konkret, shërbimi ka të bëjë me spërkatjen e kulturave bujqësore, përfshirë trajtimin kundër cikadës së rrushit. Ky trajtim nuk është shërbim i zakonshëm që mund të realizohet në çdo kohë pa ndikim në rezultat. Përkundrazi, trajtimi kundër cikadës ka karakter sezonal dhe duhet të kryhet brenda afatit të caktuar kohor, në periudhën kur ndërhyrja ka efektin e synuar.

Nëse trajtimi realizohet me vonesë ose zgjatet përtej periudhës së përshtatshme, efekti i spërkatjes mund të zvogëlohet ndjeshëm ose të mos arrihet qëllimi për të cilin është planifikuar shërbimi. Për këtë arsye, kapaciteti operativ, reagimi i shpejtë, disponueshmëria e pajisjeve dhe vazhdimësia e punës janë elemente thelbësore të kontratës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesat janë të arsyeshme, proporcionale dhe të lidhura me objektin e kontratës. Pretendimi për diskriminim dhe kufizim të konkurrencës nuk qëndron.

Pretendimi Nr. 7 Ankimor:

PRETENDIMI 7

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit, kemi dyshime serioze lidhur me përpilimin e saj, pasi mungojnë disa kërkesa bazike që zakonisht aplikohen në procedura të tilla.

Konkretisht, Dosja e Tenderit:

- nuk kërkon përvojë të mëparshme të operatorit ekonomik në punë të ngjashme;
- nuk kërkon dëshmi për qarkullim financiar;
- nuk kërkon certifikatë të TVSH-së.

Mungesa e këtyre kriterëve thelbësorë lë hapësirë për dyshime mbi përputhshmërinë e Dosjes së Tenderit me parimet dhe kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe mund të ndikojë në cilësinë dhe seriozitetin e operatorëve pjesëmarrës.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

- Të rishikojë dhe plotësojë kriteret e kualifikimit, duke përfshirë kërkesat për përvojë, qarkullim dhe TVSH;
- Të sigurojë që Dosja e Tenderit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të garantojë konkurrencë të drejtë dhe transparente.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 7 Ankimor:

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin se mungesa e kërkesës për Certifikatë të TVSH-së cenon përshtatshmërinë profesionale të operatorëve ekonomikë.

Kriteret e përshtatshmërisë profesionale janë përcaktuar në përputhje me natyrën e kontratës dhe kanë për qëllim të dëshmojnë se Operatori Ekonomik është i regjistruar për veprimtari relevante. Në njoftim kërkohet regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional/komercial ose regjistrin e ndërmarrjeve, me veprimtari të deklaruar në shërbime bujqësore dhe/ose operime me mjete ajrore pa pilot, ndërsa dëshmia e kërkuar është certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informatat e biznesit.

Certifikata e TVSH-së nuk është kriter profesional për të dëshmuar aftësinë teknike për spërkatje me dronë, as nuk dëshmon domosdoshmërisht përvojë, kapacitet teknik, pajisje, personel apo aftësi për realizimin e shërbimit. Regjistrimi në TVSH lidhet me statusin tatimor dhe qarkullimin e operatorit, jo me aftësinë profesionale për ekzekutimin e shërbimit.

Për më tepër, vendosja e Certifikatës së TVSH-së si kriter i detyrueshëm mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të rinj ose operatorëve që mund të kenë kapacitete teknike dhe profesionale për realizimin e shërbimit, por që nuk janë të regjistruar në TVSH në momentin e ofertimit. Një kërkesë e tillë do të mund të krijonte kufizim të panevojshëm të konkurrencës pa lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues sqaron se përmbushja e obligimeve tatimore kontrollohet përmes mekanizmave dhe dokumenteve përkatëse të përshtatshmërisë në fazat e parapara të procedurës, por nuk është e nevojshme që Certifikata e TVSH-së të vendoset si kriter profesional në këtë aktivitet.

Prandaj, kërkesa për shtimin e Certifikatës së TVSH-së si kriter i detyrueshëm refuzohet si e pabazuar dhe joproporcionale me objektin e kontratës.

Lidhur me pretendimin për mungesë të kërkesës për staf profesional

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet plotësisht me pretendimin se dosja e tenderit nuk garanton angazhimin e personelit të nevojshëm profesional.

Në Aneksin 1 është kërkuar që piloti i angazhuar të posedojë certifikatë A4 dhe autorizim për operime sipas kërkesave të AAC për kategori specifike. Po ashtu, janë kërkuar procedura sigurie, protokoll emergjence, metodologji për kalibrim të dozës për hektar dhe plan sezonal operativ për territorin e komunës. Këto kërkesa dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur standarde minimale për realizim profesional dhe të sigurt të shërbimit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues sqaron se nuk është e nevojshme të vendosen kritere të tepërta për numrin dhe profilet e stafit në mënyrë që të mos krijohen kufizime të panevojshme për konkurrencën. Objekti i kontratës është shërbim i spërkatjes me dronë dhe jo shërbim i veçantë i konsulencës agronomike, rilevimit gjeodezik, hartëzimit profesional apo analizës shkencore të kulturave bujqësore.

Aktivitetet si identifikimi i parcelës, koordinatat, raportimi dhe monitorimi janë pjesë mbështetëse të shërbimit të spërkatjes dhe mund të realizohen nga ekipi operativ i operatorit ekonomik, për aq kohë sa operatori dëshmon kapacitetin teknik dhe respektimin e kërkesave të dosjes.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të kërkonte ekspertë të veçantë agronomie, gjeodezie, GIS, topografie apo analizë profesionale fitosanitare, atëherë këto kërkesa do të duhej të specifikoheshin si shërbime të veçanta. Për këtë aktivitet, kërkesa thelbësore është që shërbimi të kryhet nga operatori/pilot i autorizuar për UAS dhe që operatori ekonomik të ketë pajisjet, procedurat dhe kapacitetin për raportim dhe realizim të sigurt.

Për këtë arsye, pretendimi që mungesa e një liste të detajuar të stafit e bën tenderin të papërshtatshëm nuk qëndron. Megjithatë, për qëllime qartësimi, Autoriteti Kontraktues mund të saktësojë se operatori ekonomik duhet të angazhojë personel të mjaftueshëm teknik dhe operativ për realizimin e shërbimit, duke përfshirë së paku pilotin/operatorin e certifikuar UAS dhe personelin ndihmës në terren sipas nevojës.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>